



Ne. 76 prot
Dt. 12/12/2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 11 Datë 11.12.2018

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “AFRIMI K” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim ne parim) të subjektit “AFRIMI K” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë dhe miratimin në parim të Këshillit Konsultativ, Keshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**AFRIMI K**” SH.P.K me administrator Z. Afrim DOBRUSHI, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Leshnicës** për prodhim energjie elektrike në fshatin Kolsh, Njësia Administrative Kolsh, Bashkia Kukës, Qarku Kukës .

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, HEC THANZA 2 do të ketë këto të dhëna në KRGJSH:

Koordinatat e veprës së marrjes : X - 52 84 07.56 ; Y - 46 56 379.9 ; Z - + 435.2 m

Koordinatat e godinës së centralit: X - 53 00 65.2 ; Y - 46 59 902.3 ; Z - + 300.5 m

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X - 53 00 65.2 ; Y - 46 59 902.3 ; Z - + 300.5 m

Prurja mesatare vjetore e burimit : Q mes = 1.82 m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 1.8 m³/sek;

Prurja ekologjike: Q ekol = 0.074 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q = 1.8 m³/sek.

2- Autorizimi(miratimi ne parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Cesk MILLJA

